



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KUJTESË

PËR KOMISIONIN E ZONËS
SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

14 MAJ 2023



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

1. Vendosi, Flamurin Kombëtar në një vend të dukshëm, brenda ambientit të KZAZ dhe të VNV.
2. Në mbledhjen e parë, merrni vendimin për propozimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit e KZAZ tuaj
3. Afishoni në hyrje të ambienteve të KZAZ dhe të Vendit të numërit të Votave (VNV) numrin e KZAZ, orarin e punës, numër telefoni kontakti.
4. Mbani gjithmonë me vete dhe në mënyrë të dukshme për këdo dokumentin identifikimit të funksionit tuaj, kur ju jeni në ambientet e KZAZ dhe VNV.
5. Mbikëqyrni dhe mbani të informuar KQZ për kushtet e ndërtesave ku janë vendosur QV, dhe bashkëpunoni me strukturat përkatëse poseduese, apo administruese të këtyre ndërtesave.
6. Afishoni dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për caktimin e datës së zgjedhjeve
7. Afishoni në ambientet e KZAZ/QV listën përfundimtare të zgjedhësve.
8. Verifikoni dokumentacionin e anëtarëve të KQV të propozuar nga partitë politike.
9. Merrni vendimet për emërimin e anëtarëve, kryetarit dhe sekretarit të çdo KQV, nën juridiksionin tuaj
10. Dërgoni kopjet e vendimeve për emërimin e kryetarit dhe sekretarit të çdo KQV.
11. Njoftoni orën, datën dhe vendin e trajnimeve për KQV dhe GNV dhe koordinoni pjesëmarrjen e tyre në trajnimin e KQZ.
12. Shqyrtoni kërkesat e subjekteve zgjedhore për akreditimin e vëzhguesve menjëherë dhe merrni vendimet përkatëse.
13. KZAZ, që mbulon e vetme bashkinë, pranon dhe verifikon kërkesat për regjistrimin e komitetit nismëtar.
14. KZAZ, që mbulon e vetme bashkinë, pranon kërkesat për regjistrimin e kandidatëve për kryetar apo këshill të bashkisë, verifikon dokumentacionin e aplikimeve dhe merr vendim për regjistrimin, ose jo të kandidatëve.
15. KZAZ dorëzon në KQZ një kopje të listës së kandidatëve, së bashku me formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat brenda 48 orëve nga marrja në dorëzim.
16. Kryetar, përcill menjëherë kërkesën organeve të Policisë së Shtetit, në rast të incidenteve të njoftuara nga KQV-ja;
17. Sekretar, pajis zgjedhësin, sipas kërkesës së tij, me vërtetimin përkatës, nëse emri i tij gjendet ose jo në listën përfundimtare të zgjedhësve të ZAZ-së.
18. Verifikoni që qendrat e votimit nën juridiksionin tuaj të kenë vendosur në vende të dukshme posterat në gjuhët e pakicave kombëtare
19. Organizoni vendin e numërimit të votave (VNV)
20. Siguroni, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, pajisjet logjistike të nevojshme në VNV, përfshirë edhe ndriçimin e pandërprerë, për mbarëvajtjen e procesit të numërimit të votave.
21. Ftoni, 5 ditë para datës së zgjedhjeve, subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV, për njohje të VNV
22. Merrni vendim për caktimin e numrit të grupeve të numërimit të votave
23. Njoftoni me shkrim partitë politike që kanë të drejtën, për propozimet e anëtarëve të GNV
24. Dërgoni në KQZ, kopjet e vendimeve për emërimin e anëtarëve të GNV

25. Sekretar, regjistron në LPM informacionet apo pretendimet e subjekteve zgjedhore
26. Merrni në dorëzim materialet e votimit nga KQZ
27. Informoni KQZ për masat që keni marrë për ruajtjen e materialeve zgjedhore
28. Hartoni grafikun për shpërndarjen e materialeve të votimit për KQV
29. Sekretar, dërgoju policisë së shtetit, grafikun e miratuar nga KZAZ, për dorëzimin e materialeve zgjedhore në KQV, me emrat e kryetarëve e sekretarëve të KQV dhe kontaktet e tyre.
30. Shpërndani materialet zgjedhore të KQV, jo më vonë se 15 orë përpara hapjes së votimit
31. Sekretar, informo KQZ në ditën e votimit duke filluar nga ora 06.00 për hapjen e QV dhe për fillimin e procesit të votimit.
32. Sekretar, informo KQZ për pjesëmarrjen në votim të zgjedhësve në orët 7.00; 10.00; 13.00; 19.00.
33. Sekretar, informo KQZ për numrin e QV që kanë mbyllur votimin dhe ato që nuk e kanë mbyllur në orën 19.00.
34. Sekretar, informo KQZ për Qendrat e Votimit në të cilat zgjedhjet nuk janë zhvilluar.
35. Ngrini grupet e marrjes në dorëzim, nga KQV, të kutive të votimit, të kutive të materialeve zgjedhore dhe dokumentacionit tjetër.
36. Sekretar, dokumento në LPM mospërputhjet e konstatuara gjatë marrjes në dorëzim të kutive të votimit dhe të kutive të materialeve të votimit.
37. Merrni vendimin për vlerësimin e parregullsive të kutive të konstatuara nga grupet e marrjes në dorëzim
38. Sekretar, njofto KQZ për kutitë e votimit të parregullta
39. Merrni vendimin për fillimin e procesit të numërimit të votave dhe ftoni anëtarët e GNV të ulen në tavolinat e numërimit të votave
40. Mbyllni me kode sigurie dhe plotësoni procesverbalin përkatës për kutinë e posaçme për votat e hedhura gabim për kryetarin dhe për kutinë e votave të hedhura gabim për këshillin e bashkisë.
41. Sekretar, dokumento, në procesverbalin e konstatimit, parregullsitë, pasaktësitë gjatë procesit të numërimit të votave.
42. Merrni vendime për vlerësimin e votave të kontestuar nëse ka të tilla pas rivlerësimit nga GNV.
43. Caktoni grupin e numërimit të votave për numërimin e votave të hedhura gabim.
44. Përgatisni dhe miratoni tabelën përmbledhëse të rezultetit të Zgjedhjeve
45. Shpallni kandidatët fitues për kryetar bashkie
46. Dërgoni në KQZ, në rrugë elektronike, të dhënat e tabelave të rezultateve nga GNV.
47. Sekretar, afishon në VNV, tabelat e rezultateve për QV, të firmosura e të vulosura.
48. Sekretar, merr të printuar nga operatori Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ.
49. Miratoni me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ dhe dërgojeni në KQZ
50. Sekretar, përdor platformën TEAMS të KQZ-së për dërgim dokumentacioni dhe shkëmbim informacioni me KQZ
 - Emri i përdoruesit kzaz.xx@kqz.gov.al (ku xx është numri i KZAZ-së)
 - Fjalëkalimi dërgohet nga KQZ, individualisht tek sekretari.



Për ndihmë nga KQZ telefono pa pagesë në

0800 0803

Skano QR Code më poshtë për Telegram dhe Whatsapp
për te marrë udhëzimet & informacionet në kohë reale nga KQZ



SHKARKO, në telefonin tënd celular aplikacionin "KQZ", për të marrë
informacion dhe për të raportuar në KQZ, sipas udhëzimeve përkatëse.

